FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al
www.qpz.gov.al

Akte të papublikuara **Ekstra 34** **2009**

Vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, datë 18.12.2007 — Seksioni i katërt çështja Marini kundër Shqipërisë (Ankimi nr.3738/02) 3

SEKSIONI I KATËRT ÇËSHTJA MARINI KUNDËR SHQIPËRISË
Ankimi nr.3738/02)

VENDIM

STRASBOURG

18 DHJETOR 2007

Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.

Në çështjen "Marini kundër Shqipërisë",

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i katërt), me trup gjykues të përbërë nga:

Sir Nicolas Bratza, President,
Z. J. Casadevall,
Z. G. Bonello,
Z. K. Traja,
Z. S. Pavlovschi,
Z. J. Šikuta,
Znj. P. Hirvelä, gjyqtarë,
dhe Z. T.L. Early, Kryesekretar,
pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më datë 2 tetor 2007 dhe 27 nëntor 2007,
merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në datën e fundit të përmendur.

PROCEDURA

1. Çështja filloi në bazë të ankimit nr.3738/02 kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë në përputhje me nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetas shqiptar, z. Vlash Marini (ankuesi), më 24 janar 2002.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. S. Puto, avokat që e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Pala shqiptare u përfaqësua nga Përfaqësuesja e saj Ligjore, znj. S. Mëneri, Ministria e Punëve të Jashtme.

3. Ankuesi pretendoi se autoritetet nuk kishin përmbushur detyrimet që lindnin nga themelimi i një shoqërie me kapital themeltar të ortakëve në masën 50% secili, ku secila palë zotëronte 50% të aksioneve. Ai u ankua veçanërisht për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për: mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë, tejzgjatje në kohë të procedimeve, mosarsyetim të vendimeve të gjykatës dhe mohim i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata. Duke u bazuar në nenin 13 të Konventës, ai u ankua për mungesë mjeti efektiv ligjor ankimi në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Së fundi, ai u ankua për shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të Konventës dhe nenit 14 të Konventës.

4. Më 10 prill 2006, seksioni i katërt i Gjykatës vendosi t'ia komunikonte ankimin palës shqiptare. Bazuar në dispozitat e nenit 29 § 3 të Konventës, ajo vendosi të shqyrtojë themelin e ankimit si dhe pranueshmërinë e tij.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesi u lind në vitin 1936 dhe banon në Tiranë.

A. Procedurat në Arbitrazhin Shtetëror

6. Ankuesi, një shtetas amerikan dhe shqiptar, dhe Qeveria Shqiptare themeluan në vitin 1991 një ndërmarrje të përbashkët për një periudhë prej dhjetë vjetësh. Ndërmarrja u quajt "Marini-Albplastik" dhe u specializua në prodhimin e materialeve plastike. Statuti i shoqërisë i datës 11 mars 1991 u njoh me vendim të Këshillit të Ministrave të datës 23 prill 1991. Shoqëria e re u regjistrua në regjistrin tregtar në bazë të procedurave përkatëse.

7. Asetet e shoqërisë përbëheshin nga një fabrikë dhe pajisjet e saj, me vlerë totale 1,500,000 lekë (afërsisht 12,497 euro), të cilat më parë i përkisnin një shoqërie me kapital shtetëror, të quajtur "Mandimpeks". Kontributi i ankuesit në kapitalin themeltar të shoqërisë ishte me vlerë totale 1,100,000 USD (afërsisht 834,098 euro), për t'u përdorur për rinovimin e fabrikës dhe blerjen e teknologjisë së re. Secila palë zotëronte 50% të aksioneve.

8. Më 30 maj 1991, për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në statut, ankuesi nënshkroi me Edil-Plastic, kompani italiane, një kontratë në emër të shoqërisë "Marini-Albplastik" për blerjen e teknologjisë së re për prodhimin e materialeve plastike. Ai pagoi një shumë totale prej 228,000 dollarësh (afërsisht 173,000 euro). Një shumë e dytë parash do të investohej pas fazës së parë të rinovimit të fabrikës.

9. Pasi ishte kryer 60% e rinovimit të fabrikës, shteti ndërpreu veprimtarinë e shoqërisë dhe i kërkoi ankuesit të propozonte kushte të reja bashkëpunimi. Ankuesi nuk ra dakord. Për rrjedhojë, në një vendim të datës 3 prill 1993, Këshilli i Ministrave anuloi vendimin e tij të datës 23 prill 1991 dhe në mënyrë të njëanshme shfuqizoi marrëveshjen për themelimin e shoqërisë "Marini-Albplastik".

10. Në një datë të papërcaktuar, për të përfituar dëmshpërblim, ankuesi u ankua në Arbitrazhin Shtetëror, i cili në atë kohë ishte organi kompetent për mosmarrëveshjet ku përfshiheshin ndërmarrjet me kapital shtetëror.

11. Më 7 maj 1993, Arbitrazhi Shtetëror njohu vlefshmërinë e statutit të shoqërisë "Marini-Albplastik". Për më tepër, ai urdhëroi shtetin t'i paguante ankuesit 41 milionë lekë (afërsisht 341,608 Euro) për fitimin e munguar si rezultat i ndërprerjes së veprimtarisë së shoqërisë gjatë vitit 1992 dhe 68,400 lekë (afërsisht 569 euro) për të mbuluar interesin bankar për investimin e shumës 228,000 dollarë. Më tej, ai urdhëroi shoqërinë me kapital shtetëror të përfundonte punimet e rikonstruksionit të fabrikës brenda datës 30 tetor 1993. Së fundi, Arbitrazhi Shtetëror rrëzoi kërkesën e ankuesit për t'u kompensuar për pjesën e tij të aksioneve, me arsyetimin se ato përbënin pjesë të aktivit të shoqërisë.

12. Shteti e apeloi vendimin e mësipërm në Mbledhjen e Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror. Më 7 korrik 1993, ky i fundit pranoi pjesë të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror që e urdhëronte shoqërinë të përmbushte detyrimet e saj për të vazhduar veprimtarinë e ndërmarrjes së përbashkët. Gjithashtu, ajo prishi pjesën e vendimit që i caktonte ankuesit dëmshpërblim për interesin bankar dhe fitimin e munguar dhe e dërgoi çështjen në Arbitrazhin Shtetëror për një përllogaritje të re të fitimit të munguar. Pjesa e parë e vendimit të datës 7 maj 1993 mori formë të prerë në po atë datë.

13. Më 5 nëntor 1993, në përputhje me udhëzimet e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror në vendimin e saj të datës 7 korrik 1993, Arbitrazhi Shtetëror urdhëroi shtetin t'i paguante ankuesit shumën totale prej 26 milionë lekësh (afërsisht 217,286 euro) për fitimin e munguar në vitin 1992. Vendimi mori formë të prerë në të njëjtën datë.

14. Në një datë të papërcaktuar në vitin 1993, në përputhje me vendimin e sipërpërmendur të formës së prerë, përmbaruesit ngrinë asetet e shoqërisë me kapital shtetëror dhe i paguan ankuesit shumën që i takonte prej 26 milionë lekësh.

15. Pas refuzimit të Këshillit të Ministrave për të zbatuar vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 korrik 1993, ai i bëri kërkesë Gjykatës Kushtetuese për dëmshpërblim. Më 8 nëntor 1995, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të të drejtave kushtetuese të ankuesit dhe urdhëroi që ndaj tij të zbatohej vendimi i marrë nga Mbledhja e Përgjithshme e Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror.

16. Këshilli i Ministrave e zbatoi vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Arbitrave të Arbitrazhit Shtetëror dy vjet pas daljes së tij.

B. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e vendimit të Arbitrazhit Shtetëror

17. Në një datë të papërcaktuar, shoqëria me kapital shtetëror, ortake me ankuesin në ndërmarrjen e përbashkët, iu drejtua Gjykatës së Rrethit Tiranë për shpalljen absolutisht të pavlefshëm të vendimit të Arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993, me arsyetimin se ai ishte marrë pasi Arbitrazhi kishte pushuar që qeni një trup vendimmarrës më 4 nëntor 1993. Për më tepër, ajo i kërkoi gjykatës të anulonte urdhrin e përmbarimit për ngrirjen e aseteve të saj, me synim zbatimin e vendimit të arbitrazhit.

18. Më 27 nëntor 1996 dhe 11 qershor 1997, respektivisht Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë hodhën poshtë ankimin e shoqërisë dhe lanë në fuqi vendimin e Arbitrazhit Shtetëror në favor të ankuesit. Vendimi mori formë të prerë jo më vonë se 26 qershori 1997.

C. Privatizimi i fabrikës që i përkiste ndërmarrjes së përbashkët

19. Më 13 shtator 1996 dhe 24 janar 1997, respektivisht, Agjensia Kombëtare e Privatizimit i shiti F-së godinën e fabrikës dhe tokën ngjitur saj, pavarësisht se ato ishin aktivë të shoqërisë "Marini-Albplastik".

20. Ankuesi filloi procesin kundër vendimit të privatizimit.

21. Më 10 qershor 1998, 18 dhjetor 1998, 1 dhjetor 1999, 19 dhjetor 2000 dhe 2 maj 2001, respektivisht Gjykata e Rrethit Tiranë, Gjykata e Apelit Tiranë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë dhe Gjykata Kushtetuese i konstatuan aktet e privatizimit absolutisht të pavlefshme dhe urdhëruan ndër të tjera që fabrika të trajtohet si pjesë e aseteve të shoqërisë "0Marini-Albplastik". Së fundi, gjykatat vendase urdhëruan F-në. t'u kthejë pronësinë e fabrikës dhe tokës ngjitur saj ortakëve të shoqërisë "Marini-Albplastik".

22. Pas një kërkese të bërë nga ankuesi, Gjykata e Rrethit Tiranë nxori më 17 janar 2000 një urdhër për ekzekutimin e vendimit të datës 10 qershor 1998.

23. Pavarësisht urdhrit të sipërpërmendur, Ministria e Ekonomisë dhe Financave lidhi, pa aprovimin e ankuesit, më 4 korrik 2001, një kontratë qiraje njëzetvjeçare me një tjetër shoqëri, D, e cila do ta përdorte fabrikën në fjalë për prodhim këpucësh (shiko proceset në seksionin F më poshtë). Shoqëria D, e zotëronte tashmë fabrikën dhe operonte në bazë të një kontrate qiraje katërvjeçare të lidhur me F. në vitin 1998 (shiko proceset në seksionin D me poshtë).

D. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë

24. Në vitin 1998, ndërsa nuk ishte përfunduar procesi mbi ligjshmërinë e vendimeve të privatizimit të fabrikës, F-ja lidhi një kontratë qiraje katërvjeçare me shoqërinë D, në bazë të së cilës kjo e fundit do të përdorte fabrikën për prodhimin e këpucëve.

25. Me qëllim pezullimin e ekzekutimit të urdhrit të gjykatës të datës 17 janar 2000, shoqëria D bëri kërkesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për pezullim të ekzekutimit të vendimit. Gjykata e pranoi kërkesën më 17 shkurt 2000.

26. Në një vendim të datës 11 maj 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë shprehej se ankuesi duhej të zbatonte kushtet e kontratës së qirasë të lidhur mes F-së dhe shoqërisë D. Më 2 shkurt 2001 gjykata e apelit la në fuqi vendimin e mësipërm.

27. Ankuesi bëri rekurs kundër vendimit në Gjykatën e Lartë.

28. Më 23 dhjetor 2002 Gjykata e Lartë konstatoi që, përderisa vendimet e privatizimit u shpallën absolutisht të pavlefshme, F. nuk kishte mundësi të lidhte një kontratë të tillë; ndaj kontrata e qirasë ishte absolutisht e pavlefshme. Gjykata prishi vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të gjykatës së apelit dhe pushoi gjykimin e çështjes.

29. Sidoqoftë, në atë kohë kishte mbaruar kontrata katërvjeçare e qirasë (më 2 tetor 2002) dhe shoqëria D., me të cilën kishte lidhje procesi, e përdorte tashmë fabrikën në bazë të një kontrate të re qiraje, kësaj radhe të lidhur me Qeverinë (shiko procesin në seksionin F më poshtë).

E. Statuti/ Kontrata e re e shoqërisë "Marini-Albplastik"

30. Më 1 shkurt 2001, ndërsa vazhdonte procesi kundër shoqërisë D, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë, Ministria e Punës dhe ankuesi ranë dakord të formojnë

një shoqëri të re "Marini-Albplastik". Shoqëria e re u krijua në bazë të statutit të shoqërisë së parë "Marini-Albplastik" të datës 11 mars 1991, vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 maj 1993 dhe vendimit përfundimtar në favor të ankuesit, të gjykatës së shkallës së parë të datës 10 qershor 1998.

31. Në bazë të nenit 9 të statutit që themeloi shoqërinë e re, "palët njohën përgjegjësitë e tyre për moszbatim të detyrimeve të përcaktuara në kontratën e parë dhe ranë dakord të paguajnë dëmet përkatëse (vendim i Arbitrazhit Shtetëror, datë 7 maj 1993 dhe vendim i Gjykatës së Rrethit Tiranë datë 10 qershor 1998)".

32. Palët ranë dakord për të qenë ortakë të përbashkët të shoqërisë me 50% të kapitalit themeltar secili për një periudhë 10-vjeçare dhe ankuesi do të kishte rolin e administratorit të shoqërisë.

33. Me një vendim të datës 18 maj 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë regjistroi shoqërinë e re me emrin "Marini-Albplastik" sh.p.k., një shoqëri prodhimi materialesh plastike, ndërmarrje në zotërim të përbashkët të ankuesit dhe një shoqërie me kapital shtetëror, që në atë kohë ishte nën përgjegjësinë e Ministrisë së Punës.

34. Më 6 shtator 2001, ortakët organizuan mbledhjen e parë të përgjithshme të asamblesë për të përcaktuar vlerën e tyre të aksioneve. Përfaqësuesi i ndërmarrjes shtetërore parashtroi se shteti do t'i regjistronte aksionet e tij në emër të shoqërisë "Marini-Albplastik" kur ankuesi të investonte pjesën e tij të aksioneve. Ankuesi nuk ra dakord, me arsyetimin se ligji parashikonte që ortakët duhej t'i investonin pjesët e tyre të kapitalit në të njëjtën kohë.

F. Procesi gjyqësor në lidhje me vlefshmërinë e kontratës së dytë të qirasë

1. Kontrata e dytë e qirasë

35. Më 4 korrik 2001, pavarësisht regjistrimit të shoqërisë së re më 18 maj 2001 dhe në shkelje të detyrimeve të marra përsipër nga Ministria e Punës më 1 shkurt 2001, Ministria e Ekonomisë dhe Financave, pa miratimin e ankuesit, lidhi një kontratë qiraje njëzetvjeçare me shoqërinë D. Në bazë të kontratës së re, shoqëria D, do ta përdorte fabrikën që i përkiste shoqërisë "Marini-Albplastik" për prodhim këpucësh.

2. Fshirja nga regjistri të aktivëve të shoqërisë "Marini–Albplastik"

36. Në lidhje me sa më sipër, Ministria e Ekonomisë dhe Financave urdhëroi më 23 korrik 2001 fshirjen e aktivëve të "Marini-Albplastik" nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme. Për rrjedhojë, fabrika dhe toka pranë saj u regjistruan si prona shtetërore.

37. Ankuesi bëri ankim kundër urdhrit pranë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe institucioneve të tjera shtetërore. Më 6 gusht 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi pezullimin e ekzekutimit të urdhrit.

38. Në një letër të 27 korrikut 2001, Zëvendës kryeministri këshilloi Ministrin e Punës, Ministrin e Ekonomisë dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të zbatonin vendimin e formës së prerë të gjykatës në favor të ankuesit.

39. Pavarësisht sa më sipër, aktivët e shoqërisë së ankuesit u fshinë nga Regjistri i Pasurive të Paluajtshme.

40. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi ngriti padi në Gjykatën e Shkallës së Parë për mungesë ligjshmërie të një mase të tillë.

41. Më 24 qershor 2002, gjykata e shkallës së parë vendosi riregjistrimin e aktivëve të shoqërisë në regjistër.

42. Më 14 janar 2003, gjykata e apelit prishi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për shkelje procedurale dhe ia dërgoi çështjen për rigjykim kësaj Gjykate.

43. Më 19 mars 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin e ankuesit, me arsyetimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 të Kodit të Procedurës Civile.

44. Në një datë të papërcaktuar, Gjykata e Rrethit Tiranë, gjatë rigjykimit të çështjes, i kërkoi likuiduesit të shoqërisë së ankuesit të ndërhynte në proces si palë e tretë (shiko procesin e paraqitur në seksionin H më poshtë).

45. Më 27 janar 2005, gjykata e rrethit gjyqësor, gjatë rigjykimit të çështjes, hodhi poshtë padinë e ankuesit me arsyetimin se ai përfaqësonte një shoqëri në likuidim dhe për rrjedhojë nuk mund të ishte palë ndërgjyqëse. Ky vendim u la në fuqi nga gjykata e apelit më 12 maj 2005.

46. Më 27 janar 2007, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin e ankuesit, me arsyetimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

G. Procesi gjyqësor për zbatimin e urdhrit të ekzekutimit të datës 17 janar 2000

47. Për sa më sipër, shoqëria D, bëri kërkesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për pezullim ekzekutimi të vendimit të nxjerrë nga e njëjta gjykatë më 17 janar 2000 (shiko paragrafin më sipër 24). Gjykata e pranoi kërkesën më 14 tetor 2002.

48. Ankuesi bëri ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

49. Më 5 janar 2003, gjykata e apelit konstatoi që shoqëria D, nuk ishte palë në procesin që çoi në nxjerrjen e urdhrit të ekzekutimit të datës 17 janar 2000, ndaj nuk plotësonte kushtet për të bërë një kërkesë të tillë.

50. Më 10 prill dhe 9 maj 2002 dhe 23 nëntor 2002 respektivisht, Avokati i Popullit dhe Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Shqipëri u bënë thirrje autoriteteve të respektonin vendimet e marra për çështjen e ankuesit.

51. Në një letër të datës 27 janar 2003, Ministri i Ekonomisë i kërkonte Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor të mos zbatonte urdhrin e gjykatës të datës 17 janar 2000, meqenëse fabrika ishte regjistruar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme si pronë shtetërore dhe për këtë arsye nuk ishte më një aset i shoqërisë "Marini-Albplastik", por pjesë e objektit të kontratës së qirasë të lidhur me një tjetër shoqëri.

52. Më 5 shkurt 2003, zyra e përmbarimit vendosi të mos zbatonte urdhrin e ekzekutimit.

53. Pas kërkesës së ankuesit në emër të shoqërisë, gjykata e shkallës së parë më datë 28 mars 2003 dhe gjykata e apelit më datë 5 qershor 2003 pranuan kërkesën e ankuesit dhe urdhëruan zyrën e përmbarimit të ekzekutonte urdhrin.

54. Zyra e përmbarimit bëri rekurs në Gjykatën e Lartë kundër këtyre vendimeve.

55. Më 23 mars 2004, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë hodhën poshtë vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit dhe e dërguan çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, me arsyetimin se gjykatat nuk kishin njoftuar për procesin gjyqësor zyrën e Avokatit të Popullit.

56. Në një datë të papërcaktuar, gjatë rigjykimit, duke marrë parasysh vendimin e dhënë prej vetë saj për likuidimin e shoqërisë, gjykata e shkallës së parë u kërkoi likuiduesve të shoqërisë "Marini-Albplastik" të bashkonin paditë në një gjykim të vetëm (shiko proceset e përmbledhura në seksionin H më poshtë). Ankuesi kundërshtoi me arsyetimin se mosmarrëveshja kishte të bënte me interesat e tij dhe jo ato të shoqërisë në likuidim.

57. Më 1 tetor 2004, me kërkesë të likuiduesit, gjykata e shkallës së parë pushoi procesin. Vendimi u la në fuqi nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë në datat 10 shkurt 2005 dhe 13 prill 2006 respektivisht.

H. Procedurat për likuidimin e "Marini-Albplastik"

58. Në vitin 2003, shoqëria shtetërore i ka kërkuar disa herë ankuesit, por pa rezultat, që në pozicionin e tij si administrator i shoqërisë "Marini-Albplastik", të thërriste mbledhjen e asamblesë.

59. Më 21 shkurt 2003, gjatë një mbledhjeje të përgjithshme të asamblesë së shoqërisë, përfaqësuesi i shoqërisë shtetërore njoftoi ankuesin për vendimin e tij për të revokuar kontratën me shoqërinë "Marini-Albplastik". Ankuesi e kundërshtoi këtë gjë. Për rrjedhojë, Ministria e Ekonomisë i kërkoi gjykatës të urdhëronte likuidimin e shoqërisë "Marini-Albplastik" dhe të aktiveve të saj, për mungesë interesimi nga ana e ankuesit për veprimtaritë e shoqërisë.

60. Më 8 maj 2003, gjykata caktoi një likuidues dhe vendosi likuidimin e "Marini-Albplastik". Vendimi i gjykatës së shkallës së parë u la në fuqi nga gjykata e apelit me vendim të datës 20 nëntor 2003. Në datë 20 korrik 2004, Gjykata e Lartë nuk pranoi rekursin që pasoi këtë

vendim, me arsyetimin se shkaku për rekursin nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

61. Në një datë të papërcaktuar, ankuesi paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar, ndër të tjera, që proceset gjyqësore ishin të parregullta, me arsyetimin se Ministria e Ekonomisë, duke mos qenë aksionare e shoqërisë "Marini-Albplastik", nuk kishte të drejtën të kërkonte likuidimin e shoqërisë dhe që proceset kishin filluar kundër ankuesit dhe jo kundër shoqërisë, përderisa Ministria e Punës, aksionarja tjetër, nuk ishte njoftuar për procesin.

62. Më 14 tetor 2004, likuiduesi i shoqërisë "Marini-Albplastik" i kërkoi ankuesit të dorëzonte llogaritë dhe vulën e shoqërisë, duke qenë se ai ishte administratori i shoqërisë. Duke pas parasysh kundërshtimin e ankuesit për të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë të thirrura nga likuiduesi, ky i fundit i kërkoi Gjykatës së Rrethit Tiranë të vërtetonte llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe të urdhëronte fshirjen e saj nga regjistri tregtar. Ankuesi kërkoi pezullim të gjykimit deri në daljen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

63. Më 6 janar 2005, Gjykata e Rrethit Tiranë hodhi poshtë kërkesën e ankuesit, vërtetoi llogaritë përfundimtare të shoqërisë dhe urdhëroi përfundimin e procesit të likuidimit. Ajo urdhëroi gjithashtu që përfundimi i procesit të likuidimit të shënohej në regjistrin tregtar. Ky vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë më 7 qershor 2005.

64. Më 27 prill 2005, Gjykata Kushtetuese, në seancë plenare me praninë e shtatë nga nëntë gjyqtarë sikurse përcaktohet nga ligji përkatës për funksionimin dhe organizimin e saj, refuzoi kërkesën e ankuesit meqënëse çështja nuk ishte votuar nga shumica e kërkuar/votat ishin ndarë në mënyrë të barabartë. Gjykata u kufizua në arsyetimin e saj në faktin që nuk u arrit shumica e kërkuar e votave për asnjë nga çështjet e ngritura në rastin e paraqitur. Në bazë të nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ankuesi u ftua të riparaqesë kërkesën (shiko paragrafin 72 më poshtë).

65. Ankuesi nuk e riparaqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese sipas nenit 74 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

II. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM PËRKATËS

A. Kushtetuta

66. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë vijojnë si më poshtë:

Neni 42 § 2

"Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj."

Neni 131

"Gjykata Kushtetuese vendos për:….

f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave."

Neni 133

"(…)

2. Gjykata Kushtetuese vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj."

Neni 142 § 3

"Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore."

B. Ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë"

67. Ligji përcakton se Gjykata Kushtetuese është autoriteti më i lartë që garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin e saj.

68. Gjykata përbëhet nga nëntë anëtarë, të cilët zgjidhen nga Presidenti i Republikës me pëlqimin e Kuvendit (neni 7).

69. Shqyrtimi paraprak i kërkesës bëhet nga një kolegj i përbërë nga 3 gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese, ku bën pjesë dhe relatori (neni 31).

70. Gjykata i gjykon çështjet në seancë plenare, ku marrin pjesë të gjithë gjyqtarët. Kuorumi i seancës plenare është 2/3 e gjyqtarëve të zgjedhur në detyrë (neni 32). Gjykata vendos me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj (neni 133 i Kushtetutës).

71. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren me shumicën e votave të të gjithë gjyqtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet (neni 72).

72. Në bazë të nenit 74 të ligjit, në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ose në atë mënyrë që asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar, Gjykata Kushtetuese vendos refuzimin e kërkesës. Vendimi për refuzimin e kërkesës nuk përbën pengesë që kërkuesi ta riparaqesë kërkesën pranë të njëjtës Gjykatë, e cila merr vendim në rast se krijohen kushtet për formimin e shumicës së kërkuar.

C. Ligji nr. 7424, datë 14.11.1990 "Për Arbitrazhin Shtetëror"

73. Ligji për Arbitrazhin Shtetëror parashikonte organizimin dhe funksionimin e Arbitrazhit Shtetëror, i cili ishte organi me juridiksion zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ku shqyrtoheshin interesat pasurorë të shtetit. Në përputhje me nenin 28 të ligjit, kur vendimet e tij merrnin formë të prerë, ishin të detyrueshme për Bankën e Shtetit, organet financiare të shtetit dhe zyrën e përmbarimit.

74. Procesi për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë fillonte me depozitimin e kërkesës në zyrën e përmbarimit gjyqësor. Sipas nenit 30 të ligjit, kundër vendimeve të Arbitrazhit Shtetëror mund të bëhej ankim në Mbledhjen e Përgjithshme të Arbitrarëve të Arbitrazhit Shtetëror.

75. Ky ligj u shfuqizua me ligjin nr.7801, datë 2.3.1994, i cili shpërndau Arbitrazhin e Shtetit.

II. LEGJISLACIONI KRAHASUES PËRKATËS

76. Materialet në dispozicion të Gjykatës paraqesin raste të ngjashme kur gjatë votimit votat ndahen në mënyrë të barabartë apo nuk arrihet shumica e kërkuar në vendimmarrjet e gjykatave të larta në një sërë shtetesh kontraktuese, që përfaqësojnë tradita të ndryshme ligjore. Nuk ekziston një praktikë e unifikuar në shtetet kontraktuese në lidhje me dukurinë e ndarjes së votave në mënyrë të barabartë apo mosarritjes së shumicës së kërkuar në vendimet që merren nga gjykatat e larta dhe kushtetuese. Shumë shtete parashikojnë masa për të shmangur një dukuri të tillë dhe për të siguruar shumicën e votave, që do të thotë, duke krijuar kolegje të përbëra nga një numër tek gjyqtarësh (për shembull në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Poloni, Maltë dhe Mbretërinë e Bashkuar) dhe/ose duke mos i lejuar gjyqtarët të abstenojnë (për shembull në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Moldavi) dhe ose duke përcaktuar një numër tek gjyqtarësh për të siguruar kuorumin për të marrë vendim (për shembull në Itali, Andora dhe Austri). Sidoqoftë, edhe në këto rrethana mundet të ndodhë që të ndahen votat në mënyrë të barabartë ose të mos arrihet shumica e kërkuar. Për të siguruar marrjen e një vendimi përfundimtar, pavarësisht se ndodh kjo dukuri, sisteme të ndryshme ligjore japin zgjidhje të ndryshme, që do të thotë se vendos vota e kryetarit të gjykatës/kolegjit (për shembull në Austri, Itali dhe Spanjë) ose vendos vota e relatorit të gjyqit (për shembull në Andora) ose duke bërë një interpretim të ndarjes së votave në mënyrë të barabartë (për shembull në Gjermani, Poloni, Sllovaki dhe Moldavi). Në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë ose nuk arrihet shumica e kërkuar, sistemi ligjor shqiptar bën shtyrjen e çështjes deri në një kohë të papërcaktuar, derisa rrethanat që sollën ndarjen e votave në mënyrë të barabartë apo mosarritjen e shumicës së kërkuar nuk ekzistojnë më (shiko paragrafin 72 më sipër).

E DREJTA

77. Duke iu referuar nenit 6 § 1 të Konventës, ankuesi u ankua për mosekzekutimin nga organet të vendimit të formës së prerë, tejzgjatjen në kohë të procesit, mungesën e arsyetimit të vendimeve të gjykatës dhe mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë. Duke u mbështetur në nenin 13 të Konventës, ai u ankua për mungesë të një zgjidhjeje efektive të ankimimeve të tij sipas nenit 6. Së fundi, ankuesi u ankua për shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 dhe nenit 14 të Konventës.

78. Neni 6 § 1 i Konventës, për sa ka lidhje me çështjen, parashikon:

"1. Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile …, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj …"

79. Neni 13 i Konventës parashikon si vijon:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të bëjë ankim efektiv tek një organ i vendit të tij, edhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.".

80. Neni 1 i protokollit nr.1 të Konventës parashikon:

"Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t'i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të nxjerrë ligje, që ato i gjykojnë të domosdoshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve të tjera, ose të gjobave.".

81. Neni 14 i Konventës parashikon:

"Gëzimi i të drejtave dhe lirive të njohura në këtë Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.".

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I PALËS SHQIPTARE

A. Shpërdorimi i të drejtës së ankimit nga individi

82. Pala shqiptare kërkoi që ankimi të deklarohej i papranueshëm, meqenëse ishte shpërdoruar e drejta për ankim nga individi. Ajo deklaroi se ankuesi kishte shtrembëruar faktet e çështjes dhe kishte keqinterpretuar qëllimisht vendimet e gjykatave vendase. Në lidhje me regjistrimin e ndërmarrjes së përbashkët në vitin 1993, pala shqiptare parashtroi se ajo ishte regjistruar në regjistrin tregtar në përputhje me dispozitat e reja të ligjit nr.7667 të vitit 1993, i cili kishte hyrë në fuqi pasi ishte krijuar ndërmarrja e përbashkët në fjalë, por kishte fuqi prapavepruese. Kështu, ankuesi nuk mund të pretendonte të drejta civile nga një shoqëri e jashtëligjshme, pavarësisht faktit se Arbitrazhi Shtetëror nuk e kishte marrë parasysh këtë fakt në vendimin e tij dhe kishte konstatuar se shteti kishte përgjegjësi në menaxhimin e ndërmarrjes së përbashkët.

83. Ankuesi kundërshtoi argumentat e palës shqiptare.

84. Neni 35 § 3 II Konventës, për sa i përket çështjes, parashikon si më poshtë:

"Gjykata deklaron të papranueshme çdo kërkesë individuale të paraqitur në zbatim të nenit 34, kur çmon se kërkesa … është haptazi e pabazuar ose abuzive."

85. Gjykata përsëriti argumentin që, përveçse në raste të jashtëzakonshme, kërkesa mund të hidhet poshtë si abuzive vetëm nëse ajo bazohet me dashje në fakte të pavërteta (shiko Akdivar e të Tjerë k. Turqisë, vendim i 16 shtatorit 1996, Raporte të Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-IV, §§ 53-54; I.S. k. Bullgarisë, vendim nr. 32438/96, 6 prill 2000; dhe Varbanov k. Bullgarisë, nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X).

86. Ajo gjykon se kundërshtimi i palës shqiptare buron nga një ndryshim në mendimin ligjor mbi interpretimin e vendimeve të gjykatave vendase dhe Gjykata nuk mendon se kjo shkon deri në abuzim të së drejtës për të bërë ankim në këtë Gjykatë. Për rrjedhojë, ajo nuk e pranoi kundërshtimin e palës shqiptare.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 17 të Konventës

87. Sipas palës shqiptare, në çdo rast, neni 17 i Konventës nuk e lejonte ankuesin t'u referohej parashikimeve të nenit 6 të Konventës, për sa u përket kërkesës së tij drejtuar Gjykatës për të deklaruar vendimet e gjykatave vendase si jokushtetuese, kërkesë që nuk hynte në juridiksionin e kësaj Gjykate.

88. Ankuesi nuk bëri komente për këtë çështje.

89. Neni 17 parashikon:

"Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një shteti, grupimi apo individi të drejtë që të ndërmarrë ose të kryejnë ndonjë akt që synon cenimin e të drejtave ose lirive të njohura në këtë Konventë, ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive të parashikuara gjithashtu në këtë Konventë.".

90. Gjykata rithekson se qëllimi i nenit 17, për sa i takon grupimeve apo individëve, është të bëjë të pamundur që ata të përfitojnë nga Konventa të drejtën për t'u përfshirë në ndonjë aktivitet apo të kryejnë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të njohura në Konventë. Kështu që askush të mos mund të përfitojë nga dispozitat e Konventës për të kryer akte me synim cënimin e këtyre të drejtave dhe lirive. Kjo dispozitë, e cila është ndaluese në objektin e saj, nuk mund të interpretohet me supozim të ndërsjellë, se privon një person fizik nga liritë themelore të individit të garantuara nga nenet 5 dhe 6 të Konventës (shiko Lawless k. Irlandës (nr.3), vendim i 1 korrikut 1961, Seria A, nr. 3, fq. 45-46, § 7).

91. Në çështjen në fjalë, ankuesi nuk është mbështetur në Konventë për të justifikuar apo kryer akte në kundërshtim me të drejtat dhe liritë të njohura aty, por është ankuar, ndër të tjera, se i janë privuar garancitë e parashikuara nga neni 6 i Konventës. Ndaj, Gjykata nuk ka mundësi tjetër veçse të hedhë poshtë kundërshtimin e palës shqiptare.

C. Ankimi i depozituar jashtë afatit

92. Pala shqiptare argumentoi se ankimi ishte bërë jashtë afatit prej gjashtë muajsh të parashikuar nga Konventa. Ajo parashtroi se, meqenëse argumenti kryesor e ankuesit ishte mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të vitit 1993, i cili përbënte bazën për ankimet e mëtejshme të ankuesit, ky vendim ishte vendimi i fundit për qëllimet e nenit 35. Pra, ankimi duhet konsideruar se i është drejtuar Gjykatës jashtë afatit kohor të përcaktuar nga neni 35 i Konventës.

93. Ankuesi kundërshtoi argumentin e palës shqiptare, duke parashtruar se mosekzekutimi i vendimit të Arbitrazhit Shtetëror ishte objekti i vetëm një prej ankimeve të bëra për këtë çështje dhe që ankimet e tjera ishin më vete. Gjithashtu, edhe nëse supozohet se argumenti i palës shqiptare ishte i bazuar, ai parashtroi se afati gjashtëmujor nuk mund të zbatohej ndaj shkeljeve të vazhdueshme të pretenduara, si për shembull mosekzekutimi i një vendimi të formës së prerë. Ai u mbështet në çështjen Hornsby k. Greqisë (vendim i datës 19 mars 1997, Reportet 1997-II, fq. 508, § 35) dhe Qufaj Co. Sh.p.k. k.Shqipërisë (vendim nr.54268/00, GJEDNJR 2003-XI).

94. Gjykata vëren që ankimi në fjalë i ishte drejtuar Gjykatës më 24 janar 2002. Vendimet e formës së prerë, me qëllim përllogaritjen e afatit gjashtëmujor, në lidhje me shkallët e ndryshme të gjykimit, u morën më 2005 dhe 2006.

95. Në lidhje me ankimin për mosekzekutimin e vendimeve të formës së prerë, Gjykata konstaton, sikurse dhe ankuesi, se dështimi i organeve për të ekzekutuar vendimet e formës së prerë çoi në një situatë të pandërprerë, ndaj nuk gjen zbatim rregulli për afatin gjashtëmujor (shiko, ndër burimet e tjera zyrtare, Iatridis k. Greqisë [GC], nr.31107/96, § 50, GJEDNJ 1999-II).

96. Për këtë arsye, duhet hedhur poshtë kundërshtimi për sa i përket të gjitha ankimeve të ankuesit depozituar më 24 janar 2002.

D. Mosezaurimi i mjeteve të brendshme ligjore për ankimin për kohëzgjatjen e proceseve

97. Pala shqiptare i kërkoi Gjykatës të hidhte poshtë ankimin mbi tejzgjatjen e procesit me arsyetimin se ankuesi nuk kishte ezauruar mjetet e brendshme ligjore të ankimit. Në lidhje me këtë, ajo pretendoi se ankuesi nuk kishte bërë kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës. Pa iu referuar ndonjë praktike të gjykatave vendase, ajo theksoi efektshmërinë e kërkesës bërë Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte juridiksion të merrej me çështjet e procesit të drejtë ligjor, dhe kështu mund të siguronte vënien në vend të së drejtës, nëse ankuesi do i ishte drejtuar me një kërkesë mbi zgjatjen në kohë të procesit.

98. Ankuesi nuk ishte dakord me palën shqiptare. Ai parashtroi faktin se deri në atë kohë Gjykata Kushtetuese nuk kishte shqyrtuar kurrë më parë një kërkesë mbi tejzgjatjen në kohë të

çështjes dhe kështu të provonte efektshmërinë e një mjeti të tillë ligjor. Ai iu referua faktit se pala shqiptare nuk kishte mundur të përmendte ndonjë praktikë të kësaj Gjykate apo t'i referohej ndonjë dispozite të legjislacionit të brendshëm për të mbështetur argumentat e saj mbi çështjen.

99. Gjykata gjykon se efektshmëria e apelimit kushtetues është vendimtare për të përcaktuar nëse ankuesi i kishte mjetet e duhura ligjore në kuptimin e nenit 35 § 1 dhe nenit 13 të Konventës. Për këtë arsye, Gjykata shprehet se themeli i të dyja çështjeve duhet shqyrtuar së bashku.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

100. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për mosekzekutim të vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, tejzgjatje në kohë të proceseve, mungesë arsyetimi të vendimeve të Gjykatës së Lartë dhe kufizim të së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata, për dy shkaqe: refuzimi i kërkesës së tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shkak se çështja nuk u votua nga shumica e kërkuar dhe nxjerrja e urdhrit për likuidimin e shoqërisë, që e kishin penguar atë të vinte në lëvizje gjykatën në mbrojtje të interesave të tij.

101. Në komentet e tij të datës 11 dhjetor 2006, ankuesi vuri në dyshim paanshmërinë e Gjykatës së Lartë, me argumentimin se vendimi i datës 27 janar 2006 ishte dhënë nga i njëjti kolegj që e kishte gjykuar tashmë çështjen e tij më 19 mars 2004.

A. Pranueshmëria

1. Paanshmëria e Gjykatës së Lartë

102. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit në lidhje me paanshmërinë e kolegjit të Gjykatës së Lartë që mori vendim për çështjen e tij më datë 27 janar 2006, u bë vetëm më 11 dhjetor 2006, çka do të thotë pasi kishte kaluar afati gjashtëmujor i parashikuar nga Konventa. Në këto rrethana, ai duhet hedhur poshtë si i bërë jashtë afatit gjashtëmujor të parashikuar nga nenet 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

2. Mungesa e arsyetimit

103. Ankuesi u ankua se në vendimet e saj të datave 19 mars 2004, 20 korrik 2004 and 27 janar 2006, Gjykata e Lartë nuk kishte pranuar rekursin e tij, duke përdorur formulime standarde (me arsyetimin se shkaku për të cilin ai bënte rekurs nuk përfshihej në rastet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile). Sipas tij, duke marrë parasysh faktin se rekurset e tij kishin të bënin me një sërë çështjesh, formulimi i mësipërm nuk sqaronte arsyet e vendimit të marrë nga gjykata vendase. Duke pasur parasysh faktin se, sipas tij, arsyet e rekursit përfshiheshin të paktën në rastin e parashikuar nga neni 472, germa "a" të Kodit të Procedurës Civile, kjo formulë mospranimi *de plano* nuk merrte parasysh detyrimin e legjislacionit të brendshëm dhe të Konventës për vendime të arsyetuara.

104. Pala shqiptare kundërshtoi pretendimin e ankuesit. Ajo parashtroi se meqenëse Gjykata e Lartë kishte lënë në fuqi vendimet e Gjykatës së Apelit ndaj të cilave ankuesi kishte bërë rekurs, duhej konsideruar që ajo vërtetonte arsyetimin e këtyre gjykatave; ndaj, nuk ishte nevoja të përsëriteshin arsyet e dhëna nga ajo gjykatë.

105. Gjykata përsërit se e drejta që i garantohet një ndërgjyqësi prej nenit 6 të Konventës, përfshin të drejtën për arsyetimin e vendimeve të marra nga një gjykatë vendase për çështjen e tij. Sidoqoftë, detyrimi që ka një gjykatë vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Detyrimi për të arsyetuar vendimin varet nga natyra e vendimit në fjalë (shiko, për shembull Helle k. Finlandës, vendim i datës 19 dhjetor 1997, Raportet 1997-VIII, fq. 2929, § 56).

106. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ankuesi bëri rekurs në Gjykatën e Lartë me pretendimin se në vendimet e gjykatave më të ulëta është zbatuar keq ligji. Gjykata çmon se, sidoqoftë, arsyetimi i kufizuar që Gjykata e Lartë bëri në formulën *de plano* të vendimit të saj, tregonte pa dyshim që ankuesi nuk kishte parashtruar si bazë ligjore një nga pikat e parashikuara nga dispozita e brendshme përkatëse, që është një kërkesë për pranimin e rekursit. Gjykata vëren se kur Gjykata e Lartë nuk pranon një rekurs për shkak se nuk është parashtruar baza ligjore e çështjes, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen me një arsyetim shumë të kufizuar (shiko, *mutatis mutandis*, Nerva k. Mbreërisë së Bashkuar, vendim nr. 42295/98, 11 korrik 2000).

107. Për arsyet e sipërpërmendura, Gjykata çmon se kërkesa e ankuesit bazuar në këtë pikë të nenit 6 të Konventës, është haptazi e pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3, ndaj e papranueshme në zbatim të nenit 35 § 4 të Konventës.

3. Pjesa tjetër e ankimit

108. Për sa i përket pjesës tjetër të ankimit të ankuesit të bazuar në këtë dispozitë, konkretisht mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata, mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë dhe tejzgjatja në kohë e procesit, Gjykata çmon se ato nuk janë haptazi të pabazuara në zbatim të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo konstaton në vazhdim se këto kërkesa nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Për këtë arsye ato duhen deklaruar të pranueshme.

Gjithashtu, Gjykata çmon se edhe pse ankimi për zgjatjen e procesit ka të bëjë me të njëjtën situatë faktike si ajo e ankimit për mosekzekutim të vendimeve, dispozitat përkatëse të Konventës janë shumë të ndryshme. Ndaj, ajo do ta shqyrtojë themelin e të dy ankimeve veçmas.

B. Themeli

1. Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata

(a) Parashtrimet e palëve

109. Ankuesi u ankua që gjatë proceseve në gjykatën vendase, ishte cenuar e drejta e tij për t'u dëgjuar nga gjykata në dy aspekte. Së pari, ai u ankua për urdhrin për likuidimin e shoqërisë, që e kishte penguar atë të fillonte procesin gjyqësor në mbrojtje të interesave të tij. Më tej, ai parashtroi se gjatë proceseve vendase, ai ishte përfaqësuar nga likuiduesi, i cili kishte vepruar kundër interesave të tij.

110. Së dyti, ankuesi parashtroi që mosarritja e shumicës së votave në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të datës 27 prill 2005, kishte cenuar të drejtën e tij për t'u dëgjuar nga Gjykata Kushtetuese. Fakti që ai më pas mund të ribënte kërkesë pranë Gjykatës nuk siguronte zgjidhje, sepse mund të ndodhte përsëri që të mos arrihej shumica e kërkuar.

111. Pala shqiptare nuk bëri komente mbi ankimin për aspektin e parë. Për sa i përket ankimit në lidhje me aspektinn e dytë, ajo e kundërshtoi argumentin e tij, duke u shprehur se rrëzimi i kërkesës në rast mosarritjeje të shumicës së kërkuar parashikohej nga ligjvënësi për të garantuar parimin e sigurisë juridike. Kjo nuk sillte pasoja të përhershme, meqenëse gjykata mund ta shqyrtonte përsëri të njëjtën kërkesë sapo të ndryshonin rrethanat që kishin çuar në mosarritjen e shumicës së kërkuar të votave dhe të bëhej një kërkesë e re në Gjykatën Kushtetuese.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

112. Gjykata përsërit se neni 6 § 1 i Konventës i garanton çdo personi të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Në këtë mëyrë, ai parashikon "të drejtën për proces të rregullt", ku e drejta për t'u dëgjuar, që është e drejta për të filluar një proces gjyqësor për çështjet civile, përbën një aspekt të saj (shiko Golder k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1975, Seria A, nr. 18, fq. 17-18, §§ 35-36). Kjo e drejtë shtrihet vetëm për mosmarrëveshjet (konfliktet) për "të drejta dhe detyrime të natyrës civile", të cilat mund të thuhet, të paktën kur mund të vërtetohet, se njihen nga legjislacioni i brendshëm (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, James e të Tjerë k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1986, Seria A, nr. 98, fq. 46-47, § 81, dhe Powell e Rayner k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 21 shkurt 1990, Seria A nr. 172, fq. 16-17, § 36).

113. Më tej, "e drejta për gjykimin e çështjes" nuk është absolute. Ajo u nënshtrohet kufizimeve të nënkuptuara, veçanërisht kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një kërkese, meqenëse për vetë natyrën e tyre, nevojitet rregullimi i shtetit, i cili gëzon një rezervë të caktuar për të bërë vlerësimin në lidhje me këtë (shiko Ashingdane k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 28 mars 1985, Seria A, nr. 93, fq. 24-25, § 57). Sidoqoftë, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë apo zvogëlojnë të drejtën e personit për t'u dëgjuar në atë mënyrë apo masë sa të cënohet thelbi i së drejtës; së fundi, kufizime të tilla nuk janë në përputhje me nenin 6 § 1 nëse ato nuk kanë një synim të përligjur ose nëse nuk ka një lidhje të arsyeshme proporcionaliteti mes mjetit të përdorur dhe qëllimit që synohet të arrihet (shiko Levages Prestations Services k. Francës, vendim i datës 23 tetor 1996, Reportet 1996-V, fq. 1543, § 40).

114. Tani Gjykata do të shqyrtojë kërkesën e ankuesit duke pasur parasysh parimet e përgjithshme të sipërcituara.

(i) Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata si pasojë e procedurave të likuidimit

115. Gjykata mendon se kufizimi që iu bë ankuesit në mundësinë për të filluar proces gjyqësor synonte që t'i caktohej likuiduesit roli i përfaqësimit të shoqërisë së likuiduar në gjykatë për çështjet e ngritura mbi të drejtat e saj pasurore. Me daljen e urdhrit për likuidimin, likuiduesi është përgjegjës për administrimin e aseteve të shoqërisë. Sipas Gjykatës, në fakt, është e vetë-kuptueshme që mosmarrëveshje për çështje të tilla mund të kenë pasoja të rëndësishme në aktivët dhe pasivet e pasurisë së shoqërisë. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se kufizimi ka synuar të mbrojë të drejtat dhe interesat e të tjerëve, konkretisht ato të kreditorëve të shoqërisë. Gjykata do të vazhdojë të shqyrtojë nëse pasojat që pati ankuesi ishin në përpjestim me synimin e ligjshëm të kërkuar (shiko, *mutatis mutandis*, Luordo k. Italisë, nr.32190/96, § 86, GJEDNJ 2003-IX).

116. Sikurse Gjykata e ka konfirmuar në praktikën e saj, rreziku në një sistem të tillë qëndron në faktin se ai mund të kufizojë në mënyrë të paarsyeshme të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, veçanërisht nëse proceset tejzgjaten (në të njëjtin dokument., § 87). Gjykata vëren se për çështjen në fjalë procedurat e likuidimit zgjatën katër vjet. Ankuesi mundi të kundërshtonte procedurat e likuidimit në katër shkallë gjykimi. Ndaj, nuk mund të konsiderohet se të drejtat e tij në shqyrtim u kufizuan në mënyrë të paarsyeshme. Përveç kësaj, edhe nëse supozohet se ankimi i ankuesit kishte të bënte me sjelljen e likuiduesit, ai nuk ia doli mbanë ta provonte këtë sjellje para gjykatave vendase.

117. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata del në përfundimin se procedurat e likuidimit nuk çuan në shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata, sikurse garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës.

(ii) Mohimi i së drejtës për t'u dëgjuar nga gjykata si rezultat i mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave

118. Gjykata vëren se neni 74 i ligjit për organizimin e Gjykatës Kushtetuese (në vijim LOGJK) parashikon që Gjykata Kushtetuese duhet të rrëzojë kërkesat e personave në rast se votat ndahen në mënyrë të barabartë dhe/ose në rast se asnjë përfundim i çështjes nuk votohet nga shumica e kërkuar. Nëse ankuesi i drejtohet me një kërkesë të re Gjykatës Kushtetuese, kërkesa me të njëjtin objekt dhe që ngre të njëjtën çështje mund të rishqyrtohet më vonë prej saj.

119. Edhe pse palët kanë deklaruar se kërkesa e ankuesit është rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave, Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese ishte mbledhur në kolegj të përbërë nga shtatë gjyqtarë dhe në përputhje me nenin 72 të LOGJK, është e pamundur që gjyqtarët që marrin pjesë në gjykim të abstenojnë. Për këtë arsye, dhe në kundërshtim me pozicionin e palëve, Gjykata mundet vetëm të dalë në përfundimin se Gjykata Kushtetuese nuk mori një vendim në lidhje me kërkesën e ankuesit jo për shkak të ndarjes së votave, por për shkak të pamundësisë të saj për të siguruar shumicën në ndonjë nga çështjet e paraqitura për gjykim. Është konstatuar se nuk janë dhënë arsyet për këtë situatë të krijuar.

120. Gjykata kujton se neni 6 i Konventës nuk i detyron Shtetet Kontraktuese të krijojnë gjykata apeli apo kasacioni. Megjithatë, shteteve që krijojnë gjykata të tilla u kërkohet të sigurojnë që personat që nisin procese gjyqësore do të gëzojnë ndaj këtyre gjykatave garancitë themelore që parashikon neni 6 (shiko, ndër dokumentat e tjera zyrtare, Delcourt k. Belgjikës, vendim i datës 17 janar 1970, Seria A, nr. 11, fq. 14, § 25). Në këto garanci përfshihet e drejta për një vendim përfundimtar për çështjet e paraqitura në gjykatë, në rastin e ankuesit përfshirë një vendim mbi pranueshmërinë dhe/ose themelin e kërkesës së tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

121. Në rastin në fjalë, Gjykata Kushtetuese praktikisht nuk pranoi të merrte një vendim. Pala shqiptare mbështetet në faktin që rrëzimi i kërkesës së ankuesit nuk pati pasoja të përhershme e të pandryshueshme për të, meqenëse ai mund ta përsëriste kërkesën e tij nëse do të kishte ndryshim të atyre "rrethanave" që çuan në mosmarrjen e një vendimi nga Gjykata Kushtetuese. Megjithatë, Gjykata nuk mund të pranojë faktin që, thjesht se rrethanat mund të ndryshonin dhe ankuesi mund të kishte një vendim përfundimtar për kërkesën e tij në një kohë të papërcaktuar në të ardhmen, përmbush kërkesën për siguri juridike.

122. Pamundësia e Gjykatës Kushtetuese për të siguruar shumicën e kërkuar të votave për çështjet në shqyrtim, e la ankuesin pa një vendim përfundimtar dhe për rrjedhojë kufizoi thelbin e së drejtës së tij për t'u dëgjuar nga gjykata. Për këtë arsye, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

123. Edhe pse nuk ka lidhje me rrethanat e çështjes në fjalë, për sa i përket faktit që palët mbështeten në dispozitat e LOGJK mbi ndarjen e votave, Gjykata vëren se qëndrimi i mbajtur në Shqipëri në rast ndarjeje të barabartë të votave duket se ndryshon mjaft nga ai i adoptuar nga sistemet ligjore të shteteve të tjera kontraktuese (shiko paragrafin 76 më sipër). Në ndryshim nga sistemet e tjera ligjore, të cilët ose e pengojnë mundësinë e ndarjes së votave ose sigurojnë alternativa të ndryshme për të bërë të mundur marrjen e një vendimi përfundimtar në rast se ndodh kjo ndarje, në sistemin ligjor shqiptar ndarja e votave në mënyrë të barabartë në Gjykatën Kushtetuese çon në marrjen e një vendimi, i cili formalisht nuk i jep zgjidhje çështjes në shqyrtim. Për më tepër, nuk jepen arsyet për rrëzimin e kërkesës në raste të tilla, përveçse që votat janë ndarë në mënyrë të barabartë. Duke marrë parasysh parashtrimet e saj të mësipërme, Gjykata mundet veçse të dalë në përfundimin se parashikimi për ndarjen e votave në mënyrë të barabartë në nenin 74 të LOGJK-së nuk i shërben sigurisë juridike dhe mund të privojë ankuesin nga e drejta efektive për një vendim përfundimtar për kërkesën e tij drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

2. Mosekzekutimi i vendimeve të formës së prerë

(a) Parashtrimet e palëve

124. Ankuesi u ankua për mosekzekutimin nga ana e autoriteteve të vendimit të Arbitrazhit Shtetëror të datës 7 korrik 1993, për sa ai urdhëronte Shtetitn, si ortak të shoqërisë "Marini-Albplastik", të përmbushte detyrimet e vendosura kur u themelua shoqëria në vitin 1991. Përveç kësaj, ai u ankua për shkelje të së drejtës së tij në kuptim të këtij neni, sepse autoritetet nuk kishin ekzekutuar vendimin përfundimtar dhe të detyrueshëm të datës 10 qershor 1998, që urdhëronte që fabrika të trajtohej si pjesë e aseteve të "Marini-Albplastik" dhe të regjistrohej si pronë e saj.

125. Për sa i përket drejtimit të parë të kërkesës, pala shqiptare parashtroi që në vitin 1993 autoritetet i kishin paguar ankuesit dëmshpërblim në shumën 26 milionë lekë të caktuar nga Arbitrazhi Shtetëror. Ajo parashtroi më tej se ankuesi nuk kishte shfaqur ndonjë interes në zbatimin e pjesës së vendimit që urdhëronte përfundimin e punimeve restauruese. Për rrjedhojë, kjo pjesë e ankimit ishte e pambështetur në prova dhe një abuzim i së drejtës për ankim. Së fundi, pala shqiptare parashtroi se pjesa e dytë e ankimit të ankuesit ishte e pambështetur në prova.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

126. Gjykata përsërit se neni 6 § 1 i garanton çdo personi të drejtën që t'i dëgjohet nga një gjykatë çdo pretendim në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile; në këtë mënyrë ky nen parashikon "të drejtën për gjykimin e çështjes", ku e drejta për t'u dëgjuar nga gjykata, që do të thotë e drejta për të filluar proces gjyqësor civil, përbën njërin aspekt të saj. Sidoqoftë, kjo e drejtë do të ishte iluzionare nëse sistemi i brendshëm ligjor i shteteve kontraktuese do të lejonte që një vendim gjyqësor i formës së prerë dhe i detyrueshëm të mbetej i paekzekutuar në dëm të njërës palë. Do të ishte e pakonceptueshme që neni 6 § 1 t'i parashikonte në detaje garancitë procedurale që i sigurohen ndërgjyqësit – proces gjyqësor të drejtë, publik dhe të shpejtë – pa realizuar mbrojtjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Të interpretosh nenin 6 sikur të ketë të bëjë vetëm me të drejtën për t'u dëgjuar nga një gjykatë dhe zhvillimin e procesit, ka shumë të ngjarë të çojë në situata që nuk përputhen me parimin e shtetit të së drejtës, të cilin Shtetet Kontraktuese u zotuan të respektojnë kur ratifikuan Konventën. Ndaj, ekzekutimi i vendimeve të dhëna nga cilado gjykatë duhet konsideruar pjesë përbërëse e "procesit gjyqësor" në kuptimin e nenit 6. Vonesa në ekzekutimin e vendimit mund të justifikohet në rrethana të caktuara. Por kjo vonesë nuk duhet të jetë e tillë sa të cenojë thelbin e së drejtës të garantuar nga neni 6 § 1 (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Hornsby, cituar më sipër, fq. 510, § 40; Jasiūnienė k. Lituanisë, nr. 41510/98, § 27, 6 mars 2003; Qufaj Co. Sh.p.k. k. Shqipërisë, nr. 54268/00, § 38, 18 nëntor 2004; dhe Beshiri e të Tjerë k. Shqipërisë, nr. 7352/03, § 60, 22 gusht 2006).

127. Fillimisht Gjykata mendon se drejtimi i dytë i ankimit të ankuesit është pasojë e mospërmbushjes nga autoritetet të detyrimeve që lindën me themelimin e shoqërisë, ndaj duhet shqyrtuar bashkë me drejtimin e parë të ankimit.

128. Gjykata vëren se vendimet e arbitrazhit të vitit 1993 e urdhëronin shtetin t'i paguante ankuesit shumën prej 26 milionë lekësh (afërsisht 217,286 euro) dhe të ndiqte veprimtarinë e shoqërisë. Vendimet e arbitrazhit u lanë në fuqi nga gjykata e rrethit gjyqësor në vendimin e saj të datës 27 nëntor 1996, dhe morën formë të prerë më 26 qershor 1997.

129. Për sa i përket ekzekutimit të pjesës së parë të vendimit të arbitrazhit në fjalë, Gjykata vëren se nuk ishte kundërshtuar nga palët që autoritetet t'i paguan ankuesit shumën që i takonte prej 26 milionë lekësh.

130. Gjykata vëren më tej se nuk mund të thuhet e njëjta gjë për pjesën e dytë të vendimit, që ka të bëjë më detyrimin e Shtetit për të vazhduar veprimtarinë e shoqërisë. Ajo vëren se dështimi i autoriteteve për të respektuar atë pjesë të vendimit të formës së prerë të përmendur më sipër, ishte përcaktuar ndër të tjera edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë të datës 10 qershor 1998. Përveç kësaj, formulimi i nenit 9 të statutit të shoqërisë së re Marini-Albplastik tregon se deri në vitin 2001 autoritetet ende nuk e kishin ekzekutuar vendimin e formës së prerë në favor të ankuesit.

131. Pra Gjykata çmon se që nga viti 1993 deri në 2001, pavarësisht kërkesave të ankuesit për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare dhe të detyrueshme të Arbitrazhit Shtetëror, të lëna në fuqi me vendime të formës së prerë të gjykatave vendase, autoritetet dështuan në ekzekutimin e tyre. Në fakt, sikurse rezulton nga parashtrimet e palëve, shteti lidhi kontratë me palë të treta, duke mos marrë parasysh statusin e ankuesit si ortak i shoqërisë që zotëronte 50% të aksioneve të saj.

132. Sidoqoftë, më 1 shkurt 2001, Ministria e Punës dhe ankuesi lidhën një kontratë për të krijuar ndërmarrjen e përbashkët "Marini-Albplastik". Në bazë të kontratës, palët ranë dakord që shoqëria e re të vendosej në të njëjtën ndërtesë që kishte pasur shoqëria e parë.

133. Gjykata vëren më tej se ndërmarrja e re nuk operoi fare deri në vitin 2003, duke ditur se shteti lidhi kontrata me palë të treta, pavarësisht detyrimeve që kishte në bazë të kontratës së re.

134. Përveç kësaj, Gjykata mendon se pala shqiptare nuk dha ndonjë shpjegim se përse vendimi i arbitrazhit dhe vendimet gjyqësore të formës së prerë në favour të ankuesit nuk u ekzekutuan për mbi dhjetë vjet, që nga data kur u morën e deri në vitin 2003, kur shoqëria u likuidua dhe pushoi së ekzistuari. Nuk duket se zyra e përmbarimit apo autoritetet administrative morën ndonjë masë efektive për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

135. Për këtë arsye ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në këtë aspekt.

3. Kohëzgjatja e proceseve

(a) Parashtrimet e palëve

136. Ankuesi pretendoi se shkallët e gjykimit civil nëpër të cilat kishte kaluar nuk kishin respektuar kërkesën për "afat të arsyeshëm". Ai parashtroi se gjykatat vendase, duke mos dalë me një vendim në shkallën e parë të gjykimit, e kishin shkelur këtë kërkesë. Për më tepër, vonesa e tejzgjatur në ekzekutimin nga ana e autoriteteve të vendimeve të dhëna në favor të tij, e kishin rënduar cenimin e nenit 6.

137. Pala shqiptare kundërshtoi argumentin e ankuesit. Ajo parashtroi se proceset të cilave u referohej ankuesi nuk kishin lidhje me njëri tjetrin dhe periudhat kohore që duheshin marrë parasysh për këtë qëllim duheshin vlerësuar për secilin proces më vete. Sipas palës shqiptare, duke pasur parasysh mungesën e interesit të ligjshëm të ankuesit ndaj aktiviteteve të shoqërisë së përbashkët dhe përfshirjes së interesave të palëve të treta në biznes, proceset për çështjen në fjalë nuk mund të trajtohen si të zhvilluara në shkelje të kërkesave të nenit 6 § 1 të Konventës.

(b) Vlerësimi i Gjykatës

(i) Perudha kohore që merret parasysh

138. Gjykata vëren se ankuesi u ankua për zgjatjen e tepruar në kohë të pesë proceseve gjyqësore.

139. Procesi i parë filloi në një datë të papërcaktuar në vitin 1993, kur ankuesi bëri kërkesë në Arbitrazhin Shtetëror. Ai vazhdoi me procedurat për ekzekutimin e vendimit në favor të ankuesit

dhe përfundoi më 20 nëntor 2003, me likuidimin e shoqërisë "Marini-Albplastik", duke i bërë procedurat e mëtejshme të diskutueshme. Procesi i dytë filloi në një datë të papërcaktuar në janar të vitit 1997, kur ankuesi ngriti padi në gjykatë mbi vlefshmërinë e vendimit për privatizimin e fabrikës. Ai vazhdoi me procedurat për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë në favor të ankuesit dhe përfundoi më 13 prill 2006. Procesi i tretë filloi në vitin 2000 dhe përfundoi me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 23 dhjetor 2002 (proces që kishte të bënte me vlefshmërinë e kontratës së parë të qirasë). Procesi i katërt filloi në vitin 2001, kur ankuesi ngriti padi në gjykatë për vlefshmërinë e kontratës së dytë të qirasë dhe përfundoi më 27 janar 2006. Procesi i pestë filloi në vitin 2003 dhe përfundoi më 27 prill 2005 kur kërkesa e ankuesit u rrëzua nga Gjykata Kushtetuese për shkak të mosarritjes së shumicës së kërkuar të votave.

140. Periudha që duhet marrë në shqyrtim për ankimet në tërësi fillon më 2 tetor 1996, kur hyri në fuqi njohja që Shqipëria i bëri të drejtës për paraqitje të kërkesave nga individët. Pavarësisht faktit që Gjykata i mori në shqyrtim së bashku aspektet e mosekzekutimit të vendimeve të formës së prerë në procesin e parë dhe të dytë (paragrafi 127), ajo konstatoi se këto procese nuk kishin lidhje me njëra-tjetrën dhe për rrjedhojë ajo do ta shqyrtojë më vete zgjatjen në kohë të secilit proces të sipërpërmendur. Kështu, pesë proceset zgjatën shtatë vjet, nëntë vjet, dy vjet, pesë vjet dhe dy vjet, respektivisht.

(ii) Afati i arsyeshëm i zgjatjes së procesit

141. Sipas nenit 6 të Konventës, çdo person ka të drejtë që për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij civile të jepet vendim i formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm. Për këtë arsye shtetet kontraktuese kanë detyrimin të organizojnë sistemet e tyre ligjore në mënyrë të tillë që t'i mundësojnë gjykatat të përmbushin këtë kërkesë (shiko Unión Alimentaria Sanders S.A. k. Spanjës, vendim i datës 7 korrik 1989, Seria A, nr. 157, fq.14-15, § 38).

142. Gjykata përsërit që kohëzgjatja "e arsyeshme" e procesit duhet vlerësuar në bazë të rrethanave të çështjes dhe në lidhje me kriteret e mëposhtme: kompleksiteti i çështjes, qëndrimi i ankuesit dhe i autoriteteve përkatëse dhe interesat e ankuesit në mosmarrëveshje (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Comingersoll S.A. k. Portugalisë [GC], nr. 35382/97, § 19, GJEDNJ 2000-IV).

143. Duke pasur parasysh numrin e shkallëve të gjykimit të përfshira, Gjykata nuk e konsideron zgjatjen në kohë të procesit të tretë, të katërt dhe të pestë të jenë në një afat aq të paarsyeshëm sa të përbëjë cenim të së drejtës së ankuesit, sikurse garantohet në Konventë. Sidoqoftë, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për procesin e parë dhe të dytë.

144. Gjykata çmon veçanërisht se këto procese nuk mund të konsiderohen komplekse, meqenëse ato kishin të bënin me respektimin e detyrimeve që lindnin nga krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët me kapital themeltar në shumën 50%-50% mes ankuesit dhe shtetit. Gjithashtu duket se shteti nuk bëri përpjekje për të respektuar kushtet e kontratës. Më tej Gjykata çmon se ankuesi nuk ka ndikuar në ndonjë mënyrë në këtë vonesë.

145. Përsa i përket procesit të dytë, Gjykata vëren se çështja është dërguar në mënyrë të përsëritur për rigjykim. Ajo vëren se në raste të ngjashme, kur procesi ishte zgjatur shumë në kohë për shkak të rigjykimit të çështjeve, është vendosur që përderisa dërgimi i çështjes për rigjykim kishte ardhur për shkak të gabimeve të kryera nga gjykatat më të ulta, përsëritja e këtyre vendimeve brenda të njëjtit proces zbulon një të metë serioze në sistemin gjyqësor (shiko, përveç burimeve të tjera zyrtare, Wierciszeëska k. Polonisë, nr. 41431/98, § 46, 25 nëntor 2003, dhe Huseinović k. Sllovenisë, nr. 75817/01, § 25, 6 prill 2006). Kështu, Gjykata vëren se duke dhënë një sërë vendimesh kontradiktore në shkallë të ndryshme të gjykimit, autoritetet shqiptare kanë shfaqur një mangësi të sistemit gjyqësor për të cilin janë përgjegjës.

146. Konstatimet e mësipërme mjaftojnë për ta bërë Gjykatën të dalë në përfundimin se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket tejzgjatjes në kohë të procesit të parë dhe të dytë për çështjen konkrete.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

147. Duke u bazuar në nenin 13 të Konventës, ankuesi u ankua se mjetet ligjore të ankimit në dispozicion të tij nuk mund të ishin të efektshme dhe të përshtatshme për sa i përket ankimit të tij sipas nenit 6.

148. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument. Gjithashtu, veçanërisht në lidhje me ankimin e ankuesit për zgjatjen në kohë të proceseve, ajo parashtroi se apelimi kushtetues ishte efektiv, duke u mbështetur në të njëjtat argumente të parashtruara në vëzhgimet e saj paraprake.

149. Ankuesi e kundërshtoi argumentin e palës shqiptare në lidhje me zgjatjen në kohë të proceseve. Ai parashtroi se sistemi ligjor vendas në përgjithësi nuk siguronte një mjet të veçantë ligjor me anë të të cilit të mund të bëhej ankim për zgjatjen në kohë të proceseve.

150. Gjykata përsërit se neni 13 zbatohet vetëm kur një person ka një "pretendim të argumentueshëm" se i është shkelur një e drejtë e parashikuar në Konventë (shiko Boyle dhe Rice k. Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 27 prill 1988, Seria A, nr. 131, fq. 23, § 52). Për këtë arsye, ankuesi nuk ka një pretendim të argumentueshëm në kuptimin e këtyre aspekteve të nenit 6 që tashmë janë gjetur të papranueshme nga Gjykata dhe për rrjedhojë neni 13 është i pazbatueshëm. Ajo vazhdon se kjo pjesë e ankimit është dukshëm e pabazuar dhe duhet rrëzuar në përputhje me nenet 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës dhe që pjesa tjetër është e pranueshme.

151. Gjykata ka marrë në shqyrtim ankimin e ankuesit për mosekzekutimin nga autoritetet të vendimeve të formës së prerë në favor të tij. Ajo vëren që ankimi i ankuesit sipas nenit 13 është në thelb i bazuar në të njëjtën mungesë të mbrojtjes procedurale, që tashmë është konstatuar se ka çuar në një shkelje të nenit 6 (shiko, *mutatis mutandis*, British-American Tobacco Company Ltd. k. Holandës, vendim i datës 20 nëntor 1995, Seria A, nr. 331, fq. 29, § 91, dhe Beshiri e të Tjerë, përmendur më sipër, § 68). Në këto rrethana, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme ta shqyrtojë ankesën më vete sipas nenit 13.

152. Përsa i përket ankimit të ankuesit për mungesën e një mjeti ligjor ankimi për zgjatjen në kohë të proceseve, Gjykata përsërit se neni 13 garanton një mjet ligjor efektiv ankimi tek një organ vendas për një shkelje të pretenduar të nenit 6 § 1 që garanton të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata brenda një afati të arsyeshëm (shiko Kudła k. Polonisë [GC], nr. 30210/96, § 156, GJEDNJ 2000-XI).

153. Gjithashtu, sikurse është përcaktuar në praktikën e saj, Gjykata përsërit se mjetet ligjore të ankimit që i sigurohen palës ndërgjyqëse në nivel vendor për të bërë ankim për kohëzgjatjen e proceseve janë "efektive", në kuptim të nenit 13 të Konventës, nëse ato "[parandalojnë] shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e saj, ose [sigurojnë] dëmshpërblimin e duhur për çdo shkelje që tashmë [ka] ndodhur" (i njëjti dokument, § 158). Ndaj, neni 13 ofron alternativën që, një mjet ankimi është "efektiv" nëse ai mund të përdoret si për të përshpejtuar dhënien e vendimit nga gjykata që shqyrton çështjen, ashtu edhe për t'i siguar ndërgjyqësit dëmshpërblimin e duhur për vonesat që kanë ndodhur (dokumenti i përmendur më sipër § 159).

154. Gjykata vëren se, përveç apelimit kushtetues, sistemi ligjor shqiptar nuk siguron mjete të veçanta ankimi, si ato të përmendura nga Gjykata në çështjen Kudla (të përmendur më sipër), të cilat ankuesi t'i kishte në dispozicionin e tij për t'u dëmshpërblyer për zgjatjen e tepruar të proceseve.

155. Pala shqiptare iu referua kërkesës drejtuar Gjykatës Kushtetuese në përputhje me nenin 131 të Kushtetutës. Sipas kësaj dispozite, individët mund të bëjnë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese nëse dhe kur pretendojnë se ka shkelje të nenit 6 të Konventës. Një kërkesë e tillë merret në shqyrtim nga kjo e fundit vetëm pasi të jenë ezauruar të gjitha mjetet juridike të ankimit në gjykatat e ulta, pavarësisht vonesave të mëtejshme që kjo mund të shkaktojë.

156. Gjykata vëren më tej se, edhe duke supozuar se Gjykata Kushtetuese do të mundej në teori të ofronte dëmshpërblimin e duhur për pretendimet për kohëzgjatje të tepruar, pala shqiptare nuk mund të jepte ndonjë rast ku Gjykata Kushtetuese ka marrë vendim për një kërkesë për kohëzgjatje të tepruar. Edhe pse nuk i takon Gjykatës të marrë vendim për një çështje ende të pazgjidhur të ligjit të brendshëm, (shiko, *mutatis mutandis*, De Jong, Baljet dhe Van den Brink k.

Hollandës, vendim i datës 22 maj 1984, Seria A, nr. 77, fq. 19, § 39, dhe Horvat k. Kroacisë, nr. 51585/99, § 44, GJEDNJ 2001-VIII), mungesa e praktikës tregon pasigurinë e një mjeti të tillë ligjor në praktikë.

157. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se nuk ka prova se një ankim sipas nenit 131 të Kushtetutës mund të konsiderohet, në një shkallë të mjaftueshme sigurie, se përbën një mjet efektiv ligjor ankimi në dispozicion të ankuesit për zgjatjen e tepruar të proceseve gjyqësore.

158. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton se në çështjen konkrete ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës, sepse ankuesi nuk ka pasur mjete të brendshme ligjore ankimi që do ta lejonin të ushtronte të drejtën e tij "për t'u dëgjuar brenda një afati të arsyeshëm", sikurse garantohet nga neni 6 § 1 i Konventës. Për këtë arsye ajo rrëzon kundërshtimin paraprak të palës shqiptare (shiko paragrafin 99 më sipër).

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR.1 TË KONVENTËS

159. Ankuesi u ankua për shkelje të së drejtës së tij të pronës. Ai u mbështet në nenin 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

A. Pranueshmëria

160. Gjykata konstaton se ankimi i parashtruar në këtë pjesë nuk është dukshëm i pabazuar në kuptimin e nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo gjithashtu konstaton se nuk ka arsye të tjera për ta deklaruar këtë pjesë të ankimit të papranueshme, ndaj e deklaron atë të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

161. Ankuesi pretendoi se pas dështimit të stërzgjatur të ortakut të tij, "Shtetit, për të përmbushur detyrimet e tij të lindura me krijimin e ndërmarrjes së përbashkët "Marini-Albplastik", dhe ndryshimet në aktivitetin prodhues të fabrikës si rezultat i kontratave të lidhura mes shtetit dhe palëve të tjera, pjesa e tij e aksioneve në këtë shoqëri është reduktuar në vlerë dhe për pasojë ai kishte humbur kontrollin mbi veprimtarinë dhe asetet e shoqërisë.

162. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë argument duke u mbështetur në mungesën e interesit nga ana e ankuesit për administrimin e duhur të shoqërisë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

(a) Zbatueshmëria e nenit 1 të protokollit nr.1

163. Gjykata përsërit se, sipas praktikës së saj, neni 1 i protokollit nr.1 përfshin tre rregulla të veçanta: "Rregulli i parë, i shprehur në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është i një natyre të përgjithshme dhe përcakton qartë parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregulli i dytë, që shprehet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, trajton privimin nga prona dhe ia nënshtron atë kushteve të veçanta; rregulli i tretë, i shprehur në paragrafin e dytë, u njeh shteteve kontraktuese, ndër të tjera, të drejtën për të kontrolluar përdorimin e pronës në përputhje me interesin e përgjithshëm. Sidoqoftë, të tre rregullat nuk janë "të veçanta" në kuptimin e të qenit të palidhura. Rregulli i dytë dhe i tretë kanë të bëjnë me raste të veçanta të ndërhyrjes në të drejtën e gëzimit të qetë të pronës, ndaj duhen interpretuar duke pasur parasysh parimin e përgjithshëm të shprehur qartë në rregullin e parë" (shiko Beyeler k. Italisë [GC], nr. 33202/96, § 98, GJEDNJ 2000-I).

164. Gjykata konstaton që aksionet që zotëronte ankuesi kishin pa dyshim një vlerë financiare dhe përbënin "pronë" në kuptimin e nenit 1 të protokollit nr.1. Për këtë arsye ajo e çmon nenin 1 të aplikueshëm.

165. Gjithashtu Gjykata duhet të vendosë se cila dispozitë e nenit 1 është e zbatueshme në rastin konkret. Ajo vëren në lidhje me këtë, se një "aksion i shoqërisë" është diçka komplekse. Ai vërteton se mbajtësi zotëron një aksion në shoqëri së bashku me të drejtat përkatëse. Kjo nuk përbën vetëm një pretendim indirekt ndaj aktivëve të shoqërisë, por të drejta të tjera mund të lindin nga aksioni, veçanërisht e drejta e votimit dhe e drejta për të ushtruar ndikim në shoqëri (shiko Company S. dhe T. k. Suedisë, nr. 11189/84, vendim i Komisionit i datës 11 dhjetor 1986, Vendime dhe Raporte 50, fq. 138).

166. Gjykata vëren se në rastin konkret ankuesi zotëron 50% të aksioneve të shoqërisë "Marini-Albplastik". Pas veprimeve të përsëritura të shtetit, të cilat binin në kundërshtim me kushtet e kontratës, ankuesi nuk kishte kompetenca vendimmarrëse në shoqëri. Për rrjedhojë, ndryshuan kompetencat që ankuesi ushtronte si aksionar, që do të thotë aftësia e tij për të drejtuar shoqërinë, kontrolluar asetet e aj dhe marrë fitimet.

167. Duke pasur parasysh rrethanat e çështjes dhe duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të pronës së ankuesit, Gjykata nuk konstaton se ndërhyrjet mund të klasifikohen në ndonjë kategori të veçantë të nenit 1 të protokollit nr. 1. Për këtë arsye, ajo e çmon të nevojshme ta shqyrtojë çështjen duke pasur parasysh rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në atë nen (shiko, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding k. Ukraina, nr. 48553/99, § 93, GJEDNJ 2002-VII).

(b) Përputhshmëria me nenin 1 të protokollit nr.1

168. Gjykata u referohet tre rregullave që përmban neni 1 i protokollit nr.1 (shiko paragrafin 163 më sipër). Ajo vëren se në rastin konkret nuk ka pasur privim të drejtpërdrejtë të së drejtës së pronës nga autoritetet vendase dhe ndërhyrje të krahasueshme me një privim të tillë.

169. Gjykata vëren se ankimi i ankuesit konsiston në faktin që shteti nuk përmbushi detyrimet e tij ndaj ndërmarrjes së përbashkët, duke bërë që ai të mos mundte të ushtronte kontroll efektiv, në përputhje me ligjin, mbi aktivitetet e "Marini-Albplastik", çka solli marrjen e vendimeve të paligjshme dhe më vonë likuidimin e shoqërisë.

170. Ajo përsërit se, në bazë të nenit 1 të Konventës, çdo palë kontraktuese "do t'i njohë çdo personi që përfshihet në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në …. Konventë". Detyrimi për të garantuar ushtrimin efektiv të të drejtave të parashikuara në këtë instrument, mund të çojë në detyrime positive për Shtetin (shiko, ndër të tjera, X dhe Y k. Holandës, vendim i datës 26 mars 1985, Seria A, nr. 91, fq. 11, §§ 22-23). Në këto rrethana, Shteti nuk mundet thjesht të qëndrojë pasiv dhe "nuk ka vend për të dalluar mes veprimit dhe mosveprimit" (shiko, *mutatis mutandis*, Airey k. Irlandës, vendim i datës 9 tetor 1979, Seria A, nr. 32, fq. 14, § 25).

171. Përsa i përket së drejtës së garantuar nga neni 1 i protokollit nr.1, këto detyrime pozitive mund të imponojnë marrjen e disa masave të nevojshme për mbrojtjen e së drejtës së pronës (shiko, ndër të tjera dhe mutatis mutandis, López Ostra k. Spanjës, vendim i datës 9 dhjetor 1994, Seria A, nr. 303-C, fq. 55, § 55), edhe në rastet kur kemi të bëjmë me çështjet gjyqësore mes individëve dhe shoqërive. Kjo nënkupton veçanërisht faktin që shtetet kanë detyrimin të mundësojnë procedura ligjore që ofrojnë garancitë e duhura procedurale dhe për pasojë bëjnë të mundur që gjykatat vendase të gjykojnë me efektshmëri dhe drejtësi çdo mosmarrëveshje mes personave juridikë privatë (shiko Sovtransavto Holding, të përmendur më sipër, § 96).

172. Në rastin konkret, Gjykata ka konstatuar se shteti i paditur mban përgjegjësi për shkeljen e nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë dhe tejzgjatjen në kohë të proceseve. Në lidhje me këtë, Gjykata thjesht do t'u referohej mangësive procedurale që ajo vuri në dukje më sipër, ndërsa shqyrtoi ankimin në përputhje me nenin 6 § 1 të Konventës (shiko paragrafët 126-146 më sipër).

173. Gjykata konstaton se mungesa e vullnetit të organeve vendase dhe zyrës së përmbarimit për të përmbushur detyrimet që lindën me themelimin e shoqërisë, ndikuan në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtën e ankuesit për gëzimin e qetë të pronës së tij. Kësaj i shtohet edhe zgjatja e tepruar në kohë e proceseve në fjalë, çka krijoi pasiguri të vazhdueshme rreth ligjshmërisë së vendimit të marrë nga shteti, ortaku i ankuesit, në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë. Për rrjedhojë ankuesi u bë një aksionar pasiv, duke bërë kështu të pamundur marrjen e fitimeve të pritshme.

174. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata konstaton se mosekzekutimi nga ana e organeve të vendimeve në favor të ankuesit, mënyra si u zhvilluan proceset dhe pasiguria që iu krijua ankuesit, prishën "ekuilibrin e drejtë" që duhej ruajtur mes kërkesave të interesit publik dhe nevojës për të mbrojtur të drejtën e ankuesit për gëzim të qetë të pronës së tij. Për pasojë, shteti nuk ia doli të përmbushte detyrimin e tij për t'i garantuar ankuesit gëzimin efektiv të së drejtës së tij të pronës, sikurse garantohet nga neni 1 i protokollit nr.1.

175. Për këtë arsye ka pasur shkelje të kësaj dispozite.

V. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS

176. Duke iu referuar nenit 14 të Konventës, ankuesi u ankua që autoritetet e kishin diskriminuar atë për shkak të dyshtetësisë së tij shqiptaro-amerikane.

177. Pala shqiptare e kundërshtoi këtë fakt.

178. Gjykata konstaton se ankuesi nuk ka mundur të provojë pretendimin e tij se i ishte nënshtruar trajtimit të diferencuar diskriminues për shkak të shtetësisë së tij. Ajo vazhdon që ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet hedhur poshtë në përputhje me nenin 35 §§ 3 dhe 4 të Konventës.

VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

179. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj, dhe në qoftë se e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese mundëson vetëm një mënjanim të pjesshëm të pasojave që kanë rrjedhur nga kjo shkelje, Gjykata, kur ka vend, i cakton palës së dëmtuar një shpërblim të drejtë.".

A. Dëmet

180. Si parashtrim kryesor, ankuesi kërkoi ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të dhëna në favor të tij, që do të thotë përmbushjen nga ana e shtetit të detyrimeve të lindura me themelimin e shoqërisë. Më tej ai pretendoi shumën 6,697,000 euro për dëmin financiar të shkaktuar prej investimit të tij të kapitalit themeltar që arrin afërsisht shumën 173,000 euro, si dhe të shumës prej 2,748,000 euro për fitimin e munguar për një periudhë 13 vjeçare. Ai u mbështet në një akt ekspertimi vlerësues dhe në gjetjet e vendimit të arbitrazhit të datës 5 nëntor 1993 me qëllim vlerësimin e fitimit të munguar. Për më tepër, ai pretendoi shumën 100,000 euro për dëmin jofinanciar.

181. Pala shqiptare argumentoi se shumat e pretenduara nga ankuesi ishin të ekzagjeruara, pa propozuar shuma alternative.

182. Gjykata përsërit se, në përputhje me Konventën, vendimi në bazë të të cilit ajo konstaton shkelje i vë shtetit të paditur detyrimin ligjor për t'i dhënë fund shkeljes dhe për të ndrequr pasojat e saj. Nëse legjislacioni i brendshëm lejon vetëm ndreqje të pjesshme, neni 41 i Konventës i jep Gjykatës kompetencën t'i caktojë kompensim palës së dëmtuar për veprimin apo mosveprimin që ka çuar në konstatimin e shkeljes së Konventës. Gjykata gëzon një shkallë diskrecioni në ushtrimin e kësaj kompetence, sikurse e provon mbiemri "i drejtë" dhe togfjalëshi "kur e gjen me vend".

183. Gjykata u referohet konstatimeve të saj në çështjen Qufaj Co. sh.p.k., ku ajo vendosi që autoritetet shqiptare duhet të merrnin masat e duhura për të ekzekutuar një vendim të formës së prerë (shiko Qufaj Co. sh.p.k., e përmendur më sipër, § 54-59, si dhe, *mutatis mutandis*, Beshiri e të Tjerë, përmendur më sipër, § 109).

184. Ndër faktet që Gjykata merr në konsideratë kur vlerëson kompesimin janë dëmi financiar (humbja që në fakt është pësuar si rezultat i drejtpërdrejtë i shkeljes së pretenduar) dhe dëmin jofinanciar (dëmshpërblim për shqetësimin, parehatinë dhe pasigurinë e shkaktuar nga shkelja) dhe dëme të tjera jofinanciare (shiko, ndër të tjera Ernestina Zullo k. Italisë, nr. 64897/01, § 25, 10 nëntor 2004).

185. Përveç kësaj, nëse një apo më shumë dëmshpërblime nuk mund të përllogariten me saktësi ose nëse dallimi mes dëmit financiar dhe atij jofinanciar rezulton i vështirë, Gjykata mund të vendosë të bëjë një vlerësim të përgjithshëm (shiko Comingersoll S.A., të përmendur më sipër, § 29).

186. Gjykata kujton se në rastin konkret ajo konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr.1, për shkak se proceset gjyqësore tejkaluan kërkesën për një afat të arsyeshëm dhe që vendimi në favor të ankuesit kishte mbetur i paekzekutuar për një periudhë kohe, duke mos e lejuar atë të gëzonte pronën e tij. Për këtë arsye ekziston lidhje shkakësore mes këtyre shkeljeve të konstatuara dhe pretendimit të ankuesit për dëm financiar (shiko paragrafët 174-175 më sipër).

187. Gjykata vëren se për vetë natyrën e vendimeve të formës së prerë në favor të ankuesit dhe faktit që shoqëria "Marini-Albplastik" pushoi së ekzistuari në vitin 2003, *restitutio in integrum* është i pamundur. Sidoqoftë, dëmshpërblimi duhet bërë *in lieu*.

188. Gjykata e vlerëson të arsyeshme ta dëmshpërblejë ankuesin për dëmin financiar për humbjen e investimit të tij dhe fitimet e munguara.

189. Për sa i përket humbjes së investimit, Gjykata vëren se më datë 12 qershor 1991, sipas një kontrate mes shoqërisë "Marini-Albplastik" dhe shoqërisë "Edil-Palstic", ankuesi i pagoi kësaj të fundit shumën 173,000 euro, për të mbuluar shpenzimet për përgatitjen e një projekti të ri për rikonstruktimin e fabrikës (afërsisht 62,400 euro), si dhe një pagesë për blerjen e makinerive të reja. Gjykata konstaton më tej se makineria zotërohet ende nga ankuesi.

190. Për sa u përket fitimeve, Gjykata nuk mund t'i pranojë shumat e paraqitura nga ankuesi, dhe ajo konsideron veçanërisht spekulative përpjekjen për të llogaritur cilat mund të kishin qenë fitimet e shoqërisë. Për rrjedhojë, për të përcaktuar shumën që do të caktohet në këtë pjesë, ajo do të mbështetet edhe në vlerësimin e Arbitrazhit Shtetëror të datës 5 nëntor 1993.

191. Duke marrë parasysh materialin në dispozicion dhe faktin se pala shqiptare nuk depozitoi ndonjë kundërshtim mbi metodën e llogaritjes së dëmshpërblimit të parashtruar nga ankuesi, si dhe duke bërë vlerësimin mbi baza barazie, Gjykata i cakton ankuesit shumën totale prej 330,000 euro për dëmin financiar dhe jofinanciar.

B. Kostot dhe shpenzimet

192. Ankuesi pretendoi edhe 15,900 euro për kostot dhe shpenzimet gjyqësore para gjykatave vendase dhe 5,700 euro për ato para Gjykatës. Ai paraqiti një tabelë të detajuar për të provuar pretendimin e tij për shpenzimet për procesin në Gjykatë.

193. Pala shqiptare e kundërshtoi pretendimin pa dhënë arsye specifike.

194. Në rastin konkret, duke marrë parasysh informacionin që disponon dhe kriteret e mësipërme, Gjykata çmon të arsyeshme të caktojë shumën 5 700 euro për kostot dhe shpenzimet e proceseve para Gjykatës, por hodhi poshtë pretendimin për kostot në proceset vendase për mungesë provash.

C. Interesi i papaguar

195. Gjykata çmon të nevojshme që interesi i papaguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës duhet t'i shtohen tre për qind të pikëve.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA: UNANIMISHT

1. Vendos të bashkojë themelin e kundërshtimeve paraprake të palës shqiptare në lidhje me mosezaurimin nga ana e ankuesit të mjeteve të brendshme ligjore të ankimit në lidhje me ankimin e tij për kohëzgjatjen e proceseve.

2. I deklaron të pranueshme ankimet në lidhje me nenin 6 § 1 (përsa i përket së drejtës për t'u dëgjuar nga një gjykatë, afatit të procesit dhe mosekzekutimit të një vendimi të formës së prerë), nenin 13, të marrë së bashku me aspektin e pranueshmërisë së nenit 6 § 1, dhe nenin 1 të protokollit nr.1 dhe pjesën tjetër të ankimit të papranueshme.

3. Gjykon se nuk ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket kufizimit të pretenduar të së drejtës së ankuesit për t'u dëgjuar nga gjykata në lidhje me urdhrin e likuidimit.

4. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket mohimit të së drejtës së ankuesit për t'u dëgjuar nga një gjykatë si rezultat i mosmarrjes së një vendimi nga Gjykata Kushtetuese mbi kërkesën e tij drejtuar asaj.

5. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket mosekzekutimit të vendimit të formës së prerë të datës 7 korrik 1993.

6. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket zgjatjes së tepruar në kohë të procesit të parë dhe të dytë gjyqësor.

7. Gjykon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës përsa i përket zgjatjes së tepruar në kohë të procesit të tretë, të katërt dhe të pestë.

8. Gjykon se ka pasur shkelje të nenit 13 të Konventës përsa i përket mungesës së një mjeti efektiv ankimi nga ankuesi kundër zgjatjes së proceseve dhe rrëzoi kundërshtimin paraprak të palës shqiptare.

9. Gjykon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet më vete pjesa e mbetur e ankimit të ankuesit sipas nenit 6 të Konventës.

10. Gjykon se ka patur shkelje të nenit 1 të protokollit nr.1 të Konventës.

11. Gjykon:

a) që pala shqiptare duhet t'i paguajë ankuesit brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi merr formë të prerë, në pajtim me nenin 44 § 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhen konvertuar në monedhën vendase të shtetit të paditur, me kursin e zbatueshëm në datën e shlyerjes, plus taksat që mund të jenë të tatueshme/të ngarkohen:

(i) 330 000 euro (treqind e tridhjetë mijë euro) për dëmin financiar dhe jofinanciar;

(ii) 5700 euro (pesë mijë e shtatë qind euro) për kostot dhe shpenzimet;

(b) që nga skadimi i afatit të mësipërm tremujor deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme me një normë të barabartë me normën marxhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind të pikëve.

12. Rrëzon pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 18 dhjetor 2007, sipas neneve 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

T.L. Early
Kryesekretar

Nicolas Bratza
President

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 21.1.2009
Doli nga shtypi më 23.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja QPZ
Tiranë, 2009

Çmimi 24 lekë